


Prishtinë, data: 18.05.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze të Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, në lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 2900 dt. 22.10.2012 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **Egzon Berisha** pronar i kompanisë “Albakos” sh.p.k me adrese Bellopojë Komuna Pejë, merr këtë vendim :



A K T V E N D I M

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtresave për **Egzon Berisha** pronar i kompanisë “Albakos” sh.p.k me adrese Bellopojë Komuna Pejë,, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

A r s y e t i m

Ndaj **Egzon Berisha** pronar i kompanisë “Albakos” sh.p.k me adrese Bellopojë Komuna Pejë,, KPMM ka leshuar aktin administrativ me nr. 2900 dt. 22.10.2012

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt. 22.10.2012 dhe me dt.23.03.2021 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .



Ramiz Krasniqi
Drejtore
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, 22.10.2012

Në pajtim me nenin 59 paragrafi 1 pika (e) e Rregullores 2005/3, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerre këtë:

AKTVENDIM

Ndaj Egzon Berisha pronar i kompanisë “Albakos” me adresë fshati Bellopojë, KK Pejë i shqiptohet gjoba administrative në shumë prej 3,128.02€

Arsyetim

Gjatë inspektimit të operimeve ilegale me datën 28.09.2009, kompania “Albakos” është hasur duke operuar ilegalisht në Shfrytëzimin dhe përpunimin e resurseve minerare. Inspektimi është bërë në lokacionin fshati Bellopojë komuna e Pejës. Inspektoret e Minerave kanë konstatuar se lloji minerali që keni shfrytëzuar ishte gurë gelqerorë.

Në ditën e inspektimit ju është udhëruar me anë të urdhëresës për ndërprerje të aktivitetit ilegale të lëshuar nga Inspektoret në datën e inspektimit që menjëher të ndërprej aktivitetin e paligjshëm.

Inspektoret e Minerave kanë konstatuar se kompania Juaj me pronar Egzon Berishën aktivitetin e operimeve ilegale e zhvillonte në lokacionin me këto koordinata Y= 7440382; X=4721492; Z=737, për të cilat koordinata nuk keni poseduar Licencë për Shfrytëzim të lëshuar nga KPMM

Me datën 05.03.2010, Departamenti i Gjeodezisë në KPMM-së ka kryer matjet gjeodezike në fushën e shfrytëzimit e cila sasi e shfrytëzuar e mineralit gurë gelqerorë është prej 628.02m³

Afati për kryerjen e pagesës së gjobës administrative është 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pagesa e faturës bëhet në Bankën Qendrore të Kosovës në këtë xhironlogari 1000430070005950.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori i KPMM.

KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE NEZAVISNA KOMISIJA ZA RUDNIKE I MINERALE INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS	
PRISHTINE DREJTORI KOSOVA	NUMERET EAKTIVITETI NË SHIFRA 2900
NUMERET E SHIFRAT NË SHIFRA	021/10/20/21
PRISHTINE	

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo


Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa duke ju drejtuar Komisionit për Ankesa pranë KPMM-së në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi

Ankesa kundër këtij aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit sipas nenit 128 par.(a) të Ligjit për Procedurën Administrative.

Aktvendimi t'i dergohet:

Aktvendimi t'i dergohet:

Arkivesë së KPMM-së
Departamentit të Financave të KPMM-së
Palës



Selvetë Grajqevci-Pllana
U.D e Drejtorit
Komisioni i Pagarur për Miniera dhe Minerale